



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT
SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 13 janar 2015

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121; në mbështetje të rregullit 18 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të Udhëzimit mbi praktikat Nr. 06/2012 për funksionimin dhe strukturën e Njesisë Ligjore; si dhe në mbështetje të Rregullores për procedurat e rekrutimit, të emërimit dhe të punës provuese të stafit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 02/2013; Sekretaria shpall

KONKURS për plotësimin e vendit të punës

1.

Pozita: Këshilltar juridik (junior)
Kodi: GJ-DL 04-09
Numri i vendeve të punës: 1 (një)
Kohëzgjatja e kontratës: Pa afat

Përshkrimi i përgjithshëm i pozitës: Nën mbikëqyrje të Këshilltarit të Parë juridik dhe të gjyqtarëve përkatës, mbështet punën profesionale të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke bërë hulumtime ligjore dhe analiza dhe duke ndihmuar në hartimin e vendimeve, të raporteve dhe të materialeve të tjera juridike të hartuara nga Gjykata Kushtetuese.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Të kontribuojë në funksionimin efikas dhe efektiv të Njesisë Ligjore;
- Të mbështesë punën e këshilltarëve juridikë (senior) dhe të gjyqtarëve;
- Të mbledhë dhe të studiojë literaturën përkatëse ligjore, informacionin dhe dokumentet sipas kërkesës së këshilltarëve juridikë (senior) dhe të gjyqtarëve;
- Përgatitja e analizave krahasuese nën udhëheqjen e këshilltarëve juridikë (senior); dhe
- Të kërkojë informacionin e nevojshëm, *inter alia*, për vendimet e gjykatave të tjera kushtetuese dhe për ato të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kualifikimet minimale dhe përvoja e përgjithshme:

- Përgatitje superiore shkollore në shkenca juridike, duke preferuar njohuri të specializuar nga e drejta kushtetuese, e drejta publike apo e drejta publike ndërkombëtare; dhe
- Së paku 1 (një) vit përvojë përkatëse profesionale në çështjet juridike.

Kandidati për pozitën e Këshilltarit juridik (junior) duhet të ketë njohuri të thella profesionale, si dhe aftësi të shkëlqyeshme hulumtuese dhe analitike.

Po ashtu, kandidati duhet të demonstrojë qasje pragmatike në gjetjen e zgjidhjeve adekuate me burime të kufizuara; të ketë aftësi të zhvilluara komunikimi (në mënyrë verbale dhe me shkrim); të ketë aftësi për të identifikuar prioritetet; të ketë aftësi për të bashkëvepruar me maturi dhe me ndjeshmëri me kolegë dhe me palë; të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efikase nën presion kohor; të ketë aftësi për të trajtuar informatat e besueshme në mënyrë të duhur; të ketë aftësi të shkëlqyeshme në përdorimin e kompjuterit dhe të hulumtimit në internet.

Kandidati duhet të njohë gjuhën shqipe dhe serbe, si dhe të ketë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze, në të folur dhe në të shkruar.

Informata të përgjithshme për kandidatë

Përcaktimi i pagës, për pozitën e shpallur, bëhet në përputhje me Rregulloren e punës dhe me vendimin e Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese ofron mundësi të barabarta avancimi dhe mirëpret aplikacionet nga pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë dhe nga kandidatët femra. Politika e përfaqësimit gjinor dhe e të gjitha komuniteteve të Kosovës do të zbatohet gjatë procedurës së rekrutimit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Procedura e konkurrimit

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Gjykatës Kushtetuese dhe mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org.

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: lulzim.syla@rks-gov.net, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në Departamentin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore të Gjykatës Kushtetuese (DABNJ) në kopje fizike.

Data e fundit për pranimin e aplikacioneve, nëpërmjet e-mailit, nëpërmjet shërbimit postar apo në Zyrën e Personelit të Gjykatës Kushtetuese, është më **29 janar 2015, në orën 16.00.**

Shënim:

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen, kurse do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.